

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Avdi Dinaj, kryetar, Emine Mustafa dhe Valdete Daka, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Mirlinda Mejzini, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të dënuarit Xh. K. nga Mitrovica, për shkak të veprave penale keqpërdorimi seksual i personave nën moshën 16 vjet nga neni 198 par. 1 të KPK, mundësim i prostitucionit në tentativë nga neni 201 par. 4 lidhur me par. 1 dhe 20 të KPK, sulm seksual në tentativë nga neni 195 par. 2 nën.par. 3 lidhur me nenin 20 të KPK dhe veprën penale dhunimi nga neni 193 par. 1 të KPK, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit Xh. K., kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore Mitrovicë, P.nr. 42/2014 datë 12 shkurt 2015 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Prishtinë, PAKR.nr. 230/2015 datë 7 shtator 2015, në seancën e kolegjit të mbajtur më 10 shkurt 2016 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e të dënuarit Xh. K., paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore Mitrovicë, P.nr. 42/2014 datë 12 shkurt 2015 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Prishtinë, PAKR.nr. 230/2015 datë 7 shtator 2015.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Mitrovicë, P.nr. 42/2014 datë 12 shkurt 2015, i dënuari Xh. K., është shpallur fajtor për veprat penale keqpërdorimi seksual i personave nën moshën 16 vjet nga neni 198 par. 1 të KPK, mundësim i prostitucionit në tentativë nga neni 201 par. 4 lidhur me par. 1 dhe 20 të KPK, sulm seksual në tentativë nga neni 195 par. 2 nën.par. 3

lidhur me nenin 20 të KPK dhe veprën penale dhunimi nga neni 193 par. 1 të KPK dhe pasi që i janë caktuar dënimet për secilën vepër veç e veç, është gjykuar me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 14 (katërbëdhjetë) vite, në të cilin dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej 3.6.2013 e tutje. I është shqiptuar edhe dënimi plotësues, konfiskimi i veturave “VV Polo” me ngjyrë hiri, me targa të regjistrimit dhe “Fiat Punto” me ngjyrë të kuqe, me targa të regjistrimit, është detyruar që të paguajë shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 300 € në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Me të njëjtin aktgjykim i dënuari Xh. K., në mungesë të provave është liruar nga akuza për veprat penale sulm seksual nga neni 195 par. 4 lidhur me par. 1 të KPK, keqpërdorimi seksual i personave nën moshën 16 vjeç nga neni 198 par. 1 lidhur me par. 5 pika 3 dhe 4 të KPK, dhunimi nga neni 193 par. 4 lidhur me par. 2 pika 2 të KPK, dhunimi nga neni 193 par. 3 pika 4 dhe veprën penale mundësimi ose detyrimi në prostitucion nga neni 241 par. 3 lidhur me nenin 228 par. 8 të KPK. Është vendosur që në këtë pjesë shpenzimet e procedurës penale të bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Ky aktgjykim është ndryshuar me aktgjykimin e Gjykatës se Apelit të Kosovës PAKR.nr. 230/2015 datë 07 shtator 2015 si në vijim:

“I. me aprovimin e pjesërishtëm të ankesës së mbrojtësit të të akuzuarit Xh. K., aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, P.nr. 42/2014 datë 12.02.2015 ndryshohet përkritazi mbi vendimin për dënimin, ashtu që Gjykata e Apelit e Kosovës, të akuzuarit Xh. K., për veprën penale nën pikën I të dispozitivit të aktgjykimit, i shqipton dënimin me 4 (katër) vite burgim, për veprën penale nën pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, i shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, për veprën penale nën pikën VII të dispozitivit të aktgjykimit, i shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite dhe, për veprën penale nën pikën VIII të dispozitivit, i shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) vite, ashtu që në pajtim me nenin 80 par.2 të KPRK-së, për katër vepra penale, për të cilat është shpallur fajtorë i shqipton dënimin unik me burg në kohëzgjatje prej 11 (njëmbëdhjetë) viteve, në të cilin dënim do t’i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt. 03.06.2013 e tutje.

II. Ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, lidhur me pjesën liruese, refuzohet si e pabazuar.

III. Në pjesën tjetër aktgjykimi mbetet i pa ndryshuar.”

Kundër këtyre aktgjyqimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur i dënuari Xh. K., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja të kthehet për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Prokurori i Shtetit të Kosovës, me parashtrësën KMLP.II.nr. 10/2016 datë 28 janar 2016, ka dhënë përgjigje ndaj kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, duke propozuar që e njëjta të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e çështjes, vlerësoi pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë konform dispozitës së nenit 435 par. 1 dhe 436 par. 1 të KPPK dhe gjeti se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Në kërkesë i dënuari ka theksuar se aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira nga shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale si në vijim:

-nga neni 384 par. 1 pika 18 të KPPK, sepse aktgjykimet e kundërshtuara bazohen në provat e papranueshme, e cila shkelje konsiston në atë se provat-lista e provave të propozuara nuk janë lexuar në shqyrtimin gjyqësor, kështu nuk janë lexuar Transkriptet e propozuara, video incizimet si dhe fotoalbumi ndërsa në këto prova bazohet vendimi i gjykatës;

-është shkelur dispozita e nenit 216 si dhe ajo 329 të KPPK që ka të bëjë me rregullat e përgjithshme të paraqitjes së provave mirëpo, në kërkesë nuk precizohet se në çfarë kuptimi janë shkelur dispozita e lartpërmendura. Se gjykata e ka tejkalluar akuzën e cila shkelje konsiston në atë se Prokurori i Shtetit në shqyrtimin gjyqësor e ka modifikuar aktakuzën si vijon: “Fjalja në rreshtin e 5 të pikës 3 është ndryshuar duke e fshirë pjesën “punëtorët e UNMIK-ut” dhe pjesa tjetër e dispozitivit të pikës 3 mbetet e pandryshuar”, pra nga kjo del që është ndryshuar pika 2 e jo 3 të dispozitivit;

-vlerësimi i provave në veçanti mbrojtjes së të dënuarit si dhe provave kontradiktore nuk është bërë në pajtim me ligjin e më pas i dënuari bënë komentimin e deponimit të dëshmitarëve;

-është shkelur e drejta e tij në mbrojtje sepse kryetarja e trupit gjykues në shqyrtimin gjyqësor nuk e ka lejuar që ta paraqes mbrojtjen e tij. Në vazhdim të këtij pretendimi i dënuari

komenton procesverbalin dhe citon konstatimet nga procesverbali i shqyrtimit gjyqësor duke mos precizuar se ku konkretisht është shkelur kjo e drejtë;

-aktgjykimi i shkallës së dytë po ashtu është përfshirë me shkelje esenciale e cilat konsiston në atë se kjo Gjykatë nuk e ka shqyrtuar ankesën e tij çka mund të vërehet se në dispozitivin e aktgjykimit nuk është konstatuar se çfarë ka ndodhur me ankesën të cilën ai e ka ushtruar kundër aktgjykimit të shkallës së parë dhe

-është shkelur dispozita e nenit 390 të KPPK e cila shkelje konsiston në atë se në seancën e shkallës së dytë janë njoftuar të gjitha palët përveç të dëmtuarës S. N. e cila nuk ka qenë prezentë, shkelje kjo e cila sipas pretendimeve në kërkesë ka ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor.

Në fakt, i dënuari me këtë mjet juridik vetëm ka bërë përsëritjen e pretendimeve të paraqitura në ankesën kundër aktgjykimit të shkallës së parë, ai në kërkesë më tepër i referohet fakteve, mënyrës se si janë vërtetuar ato dhe vlerësimit të provave, në pjesën dërmuese të kërkesës merret me interpretimin dhe komentimin e dispozitave ligjore si dhe citimin e pjesëve të caktuara të procesverbalit mbi shqyrtimin gjyqësor, ndërsa fare pak jep shpjegime të cilat janë ato shkelje konkrete të cilat pretendohet me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Nuk qëndron pretendimi se aktgjykimet e kundërshtuara bazohen në provat e papranueshme, pra provat të cilat nuk janë administruar në shqyrtimin gjyqësor.

Nga shkresat e çështjes, aktgjykimi i shkallës së parë (faqja 16 dhe 17) si dhe nga faqja 13 të procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor datë 9.12.2014 rezulton se është bërë leximi formal i dëshmive dhe materialeve të paraqitura. Nga i njëjti procesverbal rezulton se i dënuari dhe mbrojtësi i tij i kanë kundërshtuar disa prej provave të administruara. Për më tepër, aktgjykimi i shkallës së parë nuk mbështetet vetëm në këto prova por edhe në provat tjera të administruara në shqyrtimin gjyqësor siç janë listuar në pikën V në faqen 16 dhe 17 të aktgjykimit të shkallës së parë, prandaj pretendimet e të dënuarit qartazi dalin si të pabazuara.

Qëndron fakti se Prokurori i Shtetit në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 28.1.2015, ka ndryshuar aktakuzën si në vijim: “Nga akuza 2 fjalia e rreshtit të 5 të akuzës së 3 duke fshirë fjalinë “punëtorët e UNMIK-ut”, pjesa tjetër e dispozitivit të akuzës 3 (tash akuza 2) është e pandryshuar”. Pra, këtu është bërë vetëm precizimi i dispozitivit. Mirëpo, kjo Gjykatë vlerëson

se në rastin konkret fare nuk bëhet fjalë për tejkalimin e akuzës për faktin se përfshirja e fjalës së cituar më lartë në dispozitivin e aktgjykimit e cila më parë është fshirë ka të bëjë vetëm me një gabim teknik e jo me shkeljet e pretenduara më lartë, për faktin se është ruajtur identiteti objektiv i akuzës.

Në kërkesë pretendohet se janë shkelur dispozitat e nenit 216 dhe 329 të KPPK, mirëpo nuk precizohet se në çfarë kuptimi janë shkelur këto dispozita. Megjithatë, kjo Gjykatë i vlerëson të pabazuara pretendimet në fjalë për faktin se dispozita e nenit 216 të KPPK i referohet marrjes dhe ruajtjes së provave gjatë hetimit nga Prokurori i Shtetit e me kërkesën e të pandehurit mirëpo, nga shkresat e çështjes nuk ka prova dhe nuk rezulton se i dëmtuari të ketë kërkuar ndonjë herë marrjen dhe ruajtjen e ndonjë prove në pajtim me këtë dispozitë ndërsa, nga ana tjetër në shqyrtimin gjyqësor të gjitha provat janë paraqitur në harmoni me dispozitën e nenit 327 dhe 339 të KPPK.

Lidhur me pretendimin se është shkelur e drejta e të dënuarit në mbrojtje sepse të njëjtit në shqyrtimin gjyqësor nuk i është lejuar që të paraqes mbrojtjen e tij, kjo Gjykatë e vlerëson si të pabazuar sepse nga shkresat e çështjes dhe procesverbali mbi shqyrtimin gjyqësor i datës 28.1.2015, në ditën e dytë të paraqitjes së mbrojtjes së tij, në faqen 29 qëndron konstatimi i gjykatës me anë të së cilës nga kryetari i trupit gjykues të dënuarit i është tërhequr vërejtja që të mos përsëriten gjërat të cilat janë shqyrtuar gjatë shqyrtimit ashtu që kryetari i trupit gjykues i drejtohet të dënuarit: “unë mund t’iu lejoj juve që të thuani disa fjalë, por nuk mund t’iu lejoj që të kaloni nëpër të gjitha akuzat e deklaratat e të analizoni çdo gjë... por ju duhet të fokusoheni tek çështjet që janë të rëndësishme për akuzat e që nuk janë prezantuar këtu deri tani”. Ky intervenim i kryetarit të trupit gjykues kjo Gjykatë vlerëson se ka qenë me qëllim që të orientojë mbrojtjen e të dënuarit në faktet e rëndësishme të çështjes prandaj këtu assesi nuk mund të bëhet fjalë për mohimin e të drejtës për të paraqitur mbrojtjen, aq më tepër kur dihet i dënuari për dy ditë ka paraqitur mbrojtjen e tij pa asnjë pengesë.

Qëndron fakti se në aktgjykimin e shkallës së dytë është konstatuar se ankesat e mbrojtësve të të dënuarit janë pjesërisht të bazuara ndërsa fare nuk është përmendur edhe ankesa e të dënuarit. Mirëpo, kjo Gjykatë vlerëson se mos përfshirja e kësaj fjalie në dispozitivin e aktgjykimit nuk paraqet shkelje në drejtim të pretendimeve nga ankesa pra nuk donë të thotë se ankesa nuk është shqyrtuar. Përkundrazi nga aktgjykimi i shkallës së dytë në arsyetimin e tij në mënyrë të qartë janë dhënë arsye edhe lidhur me ankesën e të dënuarit e cila siç rezulton nga

arsyetimi është shqyrtuar së bashku me ato të mbrojtësve të tij, për çfarë në faqen 4, 5, 6, 7 dhe 8 janë dhënë arsye të qarta për të gjitha pretendimet e paraqitura nga i akuzuari dhe mbrojtësve të tij.

Pretendimi se është shkelur dispozita e nenit 390 të KPPK, e cila shkelje sipas pretendimeve në ankesë konsiston në atë se për seancën e shkallës së dytë nuk është njoftuar e dëmtuara S. N., ndërsa të dëmtuarit të tjerë kanë qenë të njoftuar, kjo Gjykatë vlerëson si të pabazuar për faktin se dispozita e lartcekur nuk e detyron gjykatën që për seancën e shkallës së dytë të njoftoj palën e dëmtuar e një gjë të tillë nuk e ka paraparë as dispozita e nenit 410 të KPPK, ligj ky që ka qenë në fuqi deri më 31.12.2012, prandaj pretendimi i të dënuarit qartazi del si i pabazuar.

Lidhur me pretendimet për shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 370 par. 7 të KPPK si dhe pjesa tjetër e kërkesës që kanë të bëjnë me shkeljet e ligjit penal, kjo Gjykatë ka dhënë arsyetimin në aktgjykimin e saj Pml.nr 268/2015 datë 6 janar 2016, prandaj nuk e sheh të arsyeshme që arsyetimet e dhëna në aktgjykimin e cituar të përsëriten.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Pml.nr. 13/2016, më 10 shkurt 2016

Procesmbajtësja,
Mirlinda Mejzini

Kryetari i kolegjit,
Avdi Dinaj